



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.03.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DWH KOSOVA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " DWH- KOSOVA" SH.P.K. e dt.30.03.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 27.03.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 27.03.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.30.03.2023, Operatori Ekonomik " DWH KOSOVA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron , sepse nuk kemi problem me formën e prezantimit të specifikimeve tuaja si OE, nuk është motiv shkarkimi forma e prezantimit mirëpo ne si AK ju kemi refuzuar sepse specifikimet teknike që kemi kërkuar nuk përputhen me atë që keni ofruar ju.

- Me konkretisht tek kontrollori I antenës së GNSS ne kemi kërkuar një hapësirë memorizuese jo me të vogël se 64GB, ndërsa ju keni ofruar një pajisje me hapësirë memorizuese 4GB.
- Gjithashtu ne si AK, kemi kërkuar që pajisja e ofruar (GPS) të mundësoj export/import të të dhënave gjeohapësinore ne formatet DWG, CSV, ShapeFile, TXT ndërsa ju si OE në broshurat e ofruara keni prezantuar DWG/DXF(është kërkuar që të vërtetohet përmes screenshot-ave ne softuer se cili format ekziston ndërmjet DWG/DXF). Gjithashtu mungojnë edhe formatet tjera të të dhënave si CSV, ShapeFile, TXT (Nëse këto formate ekzistojnë atëherë te argumentohen përmes screenshot-ave ne softuerin e instrumentit).

Pretendimi juaj i dytë gjithashtu është i pabazuar, sepse Komisioni i vlerësimit, përbehet prej dy gjeodetëve që besojmë se është e mjaftueshme për vlerësimin e specifikimeve teknike të instrumenteve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës